

PERMBLEDHJE JO TEKNIKE

**Aktiviteti: Procesi i tharjes se
shpejte se bojës se
stampimit/printimit me ane te
ajrit te nxehte**

**Subjekti: INFORM ALBANIA shpk
NIPT: L11518003F**

PERMBLEDHJE JO TEKNIKE

Te pergjithshme

Subjekti “Inform Albania” sh.p.k ushtron veprimtarine e tij: Procesi i tharjes se shpejte se bojës se stampimit/printimit me ane te ajrit te nxehte

Vendodhja:

Rezidenca Kodra e Diellit, Selite, Tirane

Procesi teknologjik:

Inform Albania Sh.p.k kryen aktivitetin e tij ne Veprimtari te tjera qe perfshijne perdorim solventesh. 7.12.a Procesi i tharjes se shpejte se bojës se stampimit/printimit me ane te ajrit te nxehte. Aty kryhet printim dixhital me ngjyra dhe bardh e zi. Disponon 3 makineri Xeikon 500 nga te cilat dy kryejne printim me ngjyra dhe printim bardh e zi. Procesi i printimit eshte i njejte me printera ne perdorim te zakonshem zyre te teknologjise laser. Ndryshe nga shtypshkronjat offset printimi digital nuk perdor boje shtypi, por Toner i cili eshte ne gjendje pluhur (konsum vjetor rreth.

Procedura:

- Marja e fileve per prodhim format elektronik (PDF)
- Filet pergatiten per printim sipas kushteve te makinerise
- Lenda e pare qe perdoret per prodhimin e faturave vjen ne forme ruli
- Printimi behet ne forme dixhitale dublex ose simplex ne rulon
- Formati i produktit final varjon sipas kerkesave te klientit (A2 , A3, A4, A5 etj)
- Produkti i printuar kalon ne proces zarfimi (Direct mail, zarfim ne zarf, Self mailer etj)
- Produktet finale paketohen ne kuti behet dorezimi tek klienti ose posta e autorizuar prej tij

Aktualisht aktiviteti i Inform Albania sh.p.k eshte te gjitha llojet e shtypshkrimeve.

Ne kete subjekt punohet cdo dite.Ka nje staf te trajnuar dhe qe ka eksperiencen e duhur per te punuar aty. Perdoret nje teknologji moderne qe ploteson standardet europiane dhe miqesore me mjedisin. Ambjentet e punes jane te komode, te pajisura me termoizolim, sistem aspirimi dhe ventilimi per largimin e aromave qe dalin nga procesi i shtypshkrimit.

Lendet e para jane bartes dhe thelbesore ne cilesine e produktit perfundimtar dhe ne prodhimin e tij.

Jane ato lende qe hyjne ne procesin e prodhimit / linjen teknologjike te prodhimit/ proceset e punes qe ne fillim dhe pa te cilat do ishte e pamundur funksionimi i nje aktiviteti.

Lendet e para qe perdoren per shtypshkronje jane te gjitha produkte importit te nje cilesise teper te larte dhe te certifikuara. Ato jane te shoqeruara me certifikata cilesie nga vendi i origjines Lendet

e para jane: leter e tipeve te ndryshme, bojera per procesin e shtypshkrimit. Boje pluhur rreth 0.12 ton pluhur/vit

Materiale ndihmese jane ato qe ndihmojne gjate punes aty ne bashkeveprim me lendet e para sigurojne perftim te nje produkti perfundimtar cilesor dhe efektiv. Materiale ndihmese jane:pajisjet e punes qe perdoren aty, perfshire makina e e ngritjes, makina ambalazhuese etj

Shtypshkronja funksionon ne reparte me destinacion te caktuar qe lidhen natyrshem me njera-tjetren.

Repartet kryesore te shtypshkronjes jane:

- Reparti i prodhimit
- Studio e dizenjimit dhe i parapregatitjes per shtyp
- Makina e palosjes
- Makina ngjitjes
- Makina ambalazhuese

Ashtu si eshte permendur edhe me larte reparti i shtypit perbehet nga tre nenreparte. **Nenreparti i parapregatitjes**

Ky repart ndodhet ne hyrje te shtypshkronjes dhe procesi konsiston ne dizenjimin e materialeve per lastra per shtypshkrime te ndryshme.

Ne procesin e parashtypit behet:

- Dizajni
- Montimi
- Letrat vijne te gatshme nga te tretet.

Procesi i parashtypit fillon me dizajnin i cili merret me faqosjen e materialeve, dizenjimin e kopertinave, fletpalosieve, posterave etj.,ne kompjuter pastaj kalon ne menyre elektronike per montimin dhe zhvillimin per lastra.

Procesi i Shtypit

Ky proces konsiston ne printimin e materialeve nga lastrat ne leter. Ne pjesen kryesore te repartit jane instaluar makinerit e shtypshkrimit me ane te cilave realizohet shtypja e materialeve. Per tu theksuar eshte se gjithe procesi eshte automatik. Boja pluhur qe perdoret per shtypshkrim konsumohet teresisht, pra nuk krijohen mbetje.Edhe ngjyrat realizohet nga boje pluhur.Mbas perfundimit te procesit realizohet pastrimi realizohet me ane te nje aspiratori te fuqishem.

Pervec sa me siper ndertesa eshte e pajisur me:

- Impianti zjarrefikes
- Magazina per lenden e pare
- Magazina per produktin perfundimtare
- Automjetet per transport.
- Paneli energjise elektrike per makinerite
- Zyrat per administraten
- Ambiente tualete etj

Magazinimi

Pjesa e magazinimit eshte e perbere nga tre nenpjese:

- Magazina e lendes se pare
- Magazina e ambalazhit
- Magazina e produktit te gatshem

Ne magazinën e lendes se pare depozitohet lenda e pare e ardhur nga importi, e ambalazhuar ne kuti plastike.

Magazina eshte e sistemuar sipas llojit te lendes se pare dhe pajisur me rafte.

Ne magazinën e ambalazhit vendoset ambalazhi per produktin perfundimtare. Ambalazhi eshte kryesisht leter.

Sistemi i ajrimit

Gjithe ambientet e shtypshkronje jane te pajisur me sistem aspiratoresh te fuqishem te cilet bejne te mundur largimin e aromave qe munde te clirohen gjate procesit te shtypshkimit. Procesi i printimit eshte i njejte me printera ne perdorim te zakonshem zyre te teknologjise laser.

Sistemi i furnizimit me uje

Ne ndertese eshte montuar linja e furnizimit me uje i cili siqurohet nga rrjeti

Ambalazhi

Sic e kemi theksuar ambalazhi i produktit eshte leter dhe karton.

Te dhena nga mbetjet qe gjenerohen aty:

Mbetjet me karakter urban, te cilat krijohen gjate punes ne shtypshkronje eshte vendosur depozitimi i tyre prane kontenitoreve te njesise vendore per te cilat subjekti paguan edhe taksa vjetore. Per mbetjet e letres shoqeria do te lidhi kontrate me firma te treta ricikluese te licensuara, te cilat kryejne riciklimin e letres

Identifikimi dhe vleresimi i ndikimeve ne mjedis

Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme veprimtarite te cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet baze te mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimet e mbrojtjes së mjedisit
- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimi
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi "Ndotësi paguan"
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nenkupton mbrojtjen e integruar te përbërësve të mjedisit nga ndotja, si veçmas, ashtu dhe në kombinim, duke pasur parasysh ndërveprimet ndërmjet tyre dhe qysh ne fazen e planifikimit te zhvillimit te nje territori te caktuar.

- Mbrojtja e Përbërësve te mjedisit klasifikohet ne:
- Mbrojtja e ajrit
- Mbrojtja e ujërave
- Mbrojtja e tokës
- Mbrojtja e natyrës
- Ndryshimet klimatike

Ndikimet kryesore ne mjedis nga funksionimi i ketij aktiviteti konsiston ne vija te pergjithshme si me poshte:

- Ndikim ne peizazhin e zones
- Emetimet ne ajer (gaze, grimca, aroma)
- Zhurmat dhe vibrimet
- Shkarkimet e lengeta
- Ndikimi ne flore/faune
- Mbetjet e gjeneruara dhe menaxhimi i tyre
- Ndikime socio-ekonomike
- Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor

Mjedisi i ndikuar	Ndikimi	masat zbutese qe duhet te ndermerren
Pejsazhi	Ndryshim i pejisazhit te zones	Mbjellje pemesh e bimesh te cilat pershtaten me se miri me kushtet e zones ne perimetrin e te gjithë siperfaqes per minimizimin e pamjes se aktivitetit te Inform Albania sh.p.k nga subjekte perreth dhe per te permiresuar cilesine e ajrit ne zone.
Toke	Ndikim ne ndotje te tokes	Kontroll te vazhdueshem per pastertin Shtim i bimesise ne afersi per te ndihmuar ne reduktim te ndotjes se tokes.
Uje	Ndotje e ujerave siperfaqesore	Ujerat siperfaqesore ndodhet larg nga subjekti, dhe si rrjedhoje nuk preken nga veprimtaria qe ushtrohet aty.
	Ndotje e ujerave nentokesore	Kontroll te vazhdueshem per pastertine. Subjekti me aktivitetin qe ushtron nuk ka shaktuar ndotje te tokes.
Ajer	Emisione gazesh.	kontroll periodik te shkarkimeve nga mjetet e transportit. Instalim sistemi ajrimi dhe kondicionimi
	Aromat	Te merren masa per minimizimin dhe/ose mbulimin e aromave te pakendshme ne mjedisin perreth shtypshkronjesh Perdorim maskash nga punetoret per te mbrotjur shendetin.
	Zhurme, vibrime	Te kryhen kontrole peridike te gjendjes teknike te mjeteve te transportit te mbahet nen kontroll dhe te respektohen normat e udhezimit nr. 8 date 27.11.2007. te kryhet organizmi i pershtatshem ne menyre qe te shmangen levizje e dendur e mjeteve gjate oreve te nates.
Mjedisi biologjik	Flora dhe fauna	Flora dhe fauna e zones nuk do te ndikohet nga aktiviteti i subjektit, zone e varfer ne lloje bimore dhe zhtazore.
Mbetjet	Mbetje me karakter urban	Depozitim i tyre ne kosha te percaktuar nga pushteti vendor. Mbetjet e letres do transportohen nga shoqeria “KRIKET-1”shpk me te cilen eshte lidhur kontrate.
Mjedisi human	Shqetesim te banoreve te zones dhe subjekteve perreth	Te ndermerren masat e nevojshme per zhurmat, shkarkimet ne atmosfere dhe aromat. Marrje masash per oraret e punes, ne menyre qe banoret perreth te mos kene shqetesime.

	Ndikime nderkufitare	Nuk ka ndikime nderkufitare. Projekti eshte brenda territorit te Shqiperise, pra eshte pjese e ndonje shteti tjetër dhe veprimtaria e tij nuk e demton mjedisin dhe shendetin e punetoreve dhe banoreve.
	Konsumi i energjise	Energjia qe do te perdoret eshte energjia elektrike. Pas mbarimit te punes cdo pajisje do fiket per te pasur konsum energjie sa me te ulet..
	Konsumi i ujit	Furnizim me uje nga rrjeti furnizues i zones. Konsum per larje te pajisjeve te punes .
	Siguria ne pune	Punonjesit para se te punesohen i nenshtrohen nje vizite mjekesore dhe me pas pajisen me nje librezë shendetesore e cila leshohet nga Drejtoria e Shendetit Publik. Cdo punonjes eshte njohes i mire i rregullave te sigurimit ne pune dhe njohes te mire te pajisjeve. Perdorim i uniformes, maskes, dorezave gjate orarit te punes. Pajisje me sistem zjarrfikes dhe kutine e ndihmes se shpejte. Kontroll teknik i pajisjeve te punes.
	Ndikime social-ekonomike	Rritje e punesimit ne nivel lokal dhe rajonal, rritje e te ardhurave te popullsise se zones nga punesimi.

Masat zbutese te ndikimeve negative ne mjedis

Masat e pergjithshme te propozuara per zbutjen e ndikimeve negative mjedisore

Me qellim qe te parandalohen, shmangen, minimizohen dhe kontrollohen ndikimet negative mjedisore te projektit gjate zhvillimit te aktivitetit te ndertimit nga ana e shoqerise Inform Albania shpk duhet qe shoqeria te marre masat e nevojshme.

Lloji i masave per mbrojtjen e mjedisit ndahen ne:

1. Teknike
2. Organizative

Masat mbrojtese ne pune

Siguria dhe shëndeti në punë ka të bëjë me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes të shëndetit të punëmarrësve, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimin, konsultimin, pjesëmarrjen e balancuar si dhe trajnimin e formimin e punëmarrësve e përfaqësuesve të punëmarrësve në përputhje me legjislacionin përkatës.

Bazuar ne Ligjin Nr.10.237 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” objektivi i tij është përcaktimi i masave, që synojnë garantimin e sigurisë dhe të shëndetit në punë të punëmarrësve.

Qëllimi i këtij ligji është të garantojë sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimit, këshillimit, pjesëmarrjes së balancuar, në përputhje me ligjin, formimit të punëmarrësve e të përfaqësuesve të tyre si dhe të përcaktojë udhëzimet e përgjithshme për zbatimin e këtij qëllimi.

**Disa nga pikat kryesore të këtij Ligji janë:
detyrimet e punëdhënësit,**

Punëdhënësi ka detyrimin të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit fizik dhe mendor të punëmarrësve gjatë kryerjes së aktivitetit në punë. Sipas Kodit të Punës, punëdhënësi duhet të informojë punëmarrësit mbi rreziqet që lidhen me punën dhe duhet t’i kualifikojë punëmarrësit për respektimin e kërkesave në fushën e shëndetit, sigurimit dhe higjienës. Punëdhënësi për të parandaluar aksidentet dhe sëmundjet profesionale duhet të përcaktojë qartë rregullat e sigurimit teknik.

unëdhënësit janë të detyruar të ndjekin rregulla të përgjithshme të parandalimit të rreziku Duke mbajtur parasysh natyrën e veprimtarisë së ndërmarrjes/institucionit; vlerësimin e rrezikshmërisë ndaj sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve. Është e parashikuar që punëdhënësi të zhvillojë këshillime me punëmarrësit dhe me përfaqësuesit e tyre, me objekt planifikimin e futjes e teknologjive të reja, duke vënë në dukje pasojat e tyre për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve, pasoja të cilat lidhen me përzgjedhjen e pajisjeve, rregullimin e kushteve të punës dhe ndikimin e kushteve të mjedisit, të marrin masat e duhura, me qëllim që vetëm punëmarrësit, të cilët kanë marrë udhëzime të përshtatshme, të futen në zonat me rrezik të madh dhe specifik. Spas Kodit të Punës, punëdhënësi duhet të informojë punëmarrësit mbi rreziqet që lidhen me punën dhe duhet t’i kualifikojë punëmarrësit për respektimin e kërkesave në fushën e shëndetit, sigurimit dhe higjienës. Kualifikimi dhe informimi i parashikuar në paragrafin e mësipërm bëhen gjatë marrjes në punë dhe përsëriten sipas nevojës, veçanërisht në rast të ndryshimit të kushteve të punës. Punëdhënësi duhet të sigurohet që punëmarrësit të marrin trajnimin e duhur në rastet e prezantimit të teknologjive apo pajisjeve të reja të punës; në rastet e ndryshimit të procedurave të punës në masën që mund të ndikojnë shëndetin dhe sigurinë në punë. Në rastet e transferimit apo ndryshimit të punës, trajnimi mbi sigurinë dhe shëndetin në punë duhet të përshtatet me kushtet e reja specifike të punës dhe zhvillohet sipas rreziqeve të reja.

Detyrimet e punëmarrësve

Punëmarrësi për kryerjen e punës duhet të përdorë sipas rregullave të caktuara mjetet e punës, aparaturat, mjetet e punëdhënësit dhe pajisjet e vëna në dispozicion të tij.

Kontrolli i shëndetit

Cdo gjashte muaj kryhet kontroll shendetesor dhe punetoret/stafieshte i pajisur me kartelet shendeti.

Njoftimi, hetimi dhe raportimi i ngjarjeve dhe aksidenteve në punë, Punëdhënësi duhet të mbajë gjithmonë në ndërmarrje dhe t'i paraqesë inspektorit të punës dokumente përrkatëse si për shembull një kopje të deklaratave të aksidenteve në punë, që kanë ndodhur të paktën që prej tre vjetësh; dokumentin e vlerësimit të riskut për çdo vend pune, të shoqëruar me masat parandaluese, dhe listën e lëndëve të rrezikshme që përdoren në ndërmarrjen e tij.

grupet që janë të ndjeshme ndaj rrezikut, autoritetet shtetërore përgjegjëse, sanksionet, dispozita të fundit.

Per te mbajtur nje regjim te forte te sigurise ne pune dhe shendetit te plote te punonjesve do te merren masat e meposhtme:

- Jane te punesuar punonjes qe e kane mbushur moshen per pune.
- Jane te punesuar punonjes qe kane eksperience te gjate ne profesion.
- Punonjesit para fillimit te punes dhe gjate saj ne menyre periodike do te instruktohen per rreziqet ne pune dhe masat e menytrat per parandalimin e tyre.
- Masat per mbrojtjen nga zjarri jane pjese e instruktiveve e te tabelave lajmeruese e parandaluese.

Masat kunder zjarrit

Ne teritor jane vendosur ne vende te dukshme paisje te mbrojtjes nga zjarri dhe jane marre masa per te kryer instruktimin e punonjesve ne menyre periodike. Per mbrojtjen nga Zjarri marre masat e me poshteme:

- Ka fikese zjarri sipas normave.
 - Ka rregullore te brendshme te PMNZSH-se.
 - Personeli eshte i instruktuar me rregullat e PMNZSH-se.
 - Automjeti Zjarrefikes ka hapësira të mjaftueshme rruge për të hyr në objekt.
-
- **Menaxhimi i situatave te emergjences**
Situatat ne kompani mund te ndahen ne dy katogori:
 - Gjendje alarmi
 - Gjendje rreziku

Gjendja e alarmit eshte ajo gjendje ne te cilen pas marrjes se sinjalit duke i paraprire kanosjes per ndotje apo rrezik ndaj zjarrit por qe ne kete faze nuk ka nje njoftim te sigurt. Ky eshte nje rast kur personeli ne kantierin e punes me ane te mjeteve te komunikimit kalon te personat pergjegjes per organizimin e ketyre situatave.

Pas marrje se sinjalizimit pergjegjesi duhet te verifikojte vertetesine e lajmit te marre masat e nevojshme per nderhyrjen e shpejt duke vene ne gadishmeri mjetet dhe pajisjet/kapacitetet qe disponon shoqeria per nje nderhyrje te mundshme.

Gjendja e alarmit perfundon kur:

- Konstatohet mungesa e ndotjes ose kercenimi per ndotje apo zjarr
- Fillojne operacionet per eliminimit te ndotjes pra eshte kaluar ne gjendje rreziku

Gjendje rreziku

Kjo gjendje perkton me:

- Rreziku per ndotje reale
- Eshte duke ndodhur nje ndotje apo zjarr
- **Gjendja e rrezikut parashikon proceduren e komunikimit te menjehershem me departamentin pergjegjes per kete dhe ne vijim operacionet e meposhtme ne varesi te situates:**
 - Numrat e kontaktit per personelin kyc
 - Raportim i gjendjes me telefon ose me goje
 - Fikja e menjehershme e makinerive
 - Mbledhja e personelit ne vendgrumbullimin e percaktuar ku kontrollohet nese jane te gjitha
 - Njoftim i menjehershem i institucioneve per fikjen e zjarrit ne nje rast te tille
 - Vendodhjen e hidranteve dhe paisjeve te tjera kunder zjarrit
 - Masat per parandalimin e derdhjeve te metejshme ne rast derdhej te lendeve te rrezikshme
 - Aktivizimi i nje plani te tille

Ne rast zjarri qoftese jepet urdher per evakuim atehere:

- Duhet te kuptohet teresisht procedurat e evakuimit
- Te perdoren sistemet e vena ne dispozicion per te njoftuar personelin per evakuim
- Te ruhet qetesia
- Rast zjarri – te mbyllni te gjitha dyert dhe dritaret
- Te largoheni nga rruga e drejtperdrejt.

Ne kete rast vlen per tu permendur kutite e ndihmes se shpejt te cilet duhet te permbajne:

- Doreza nje perdorimshe
- Flakon Jodi 10% 125 ml
- Falkon uji fiziologjik 0.9% NaCl 250 ml
- 3 konfeksione garzash sterile me permasa 10x10
- 1 konfeksion garze sterile me permasa 18x40
- 1 pincete sterile njeperdorimshe
- 1 konfeksion manikotash me permasa te ndryshme
- Pambuk
- Gershere

Ne rast te aksidenteve me ndikim ne mjedis

- Duhet te respektohet procedura per izolimin dhe minimizimin e ndikimit ne mjedis
- Te nderpritet puna dhe te fiken pajisjet
- Te sigurohet siguria e punonjesve qe do te marrin pjese ne operacionin menaxhimit te aksidentit duke u pajisur me mjetet mbrojtese ne rast nevoje si maska, doreza apo uniforma rezistente
- Te perdoren mjetet e nevojshme te vena ne dispozicion
- Mjetet e punes duhet te perdoren nga operatoret e trajnuar per kete qellim
- Te behet rregjistrimi i aksidentit dhe hapat e ndermarra per mbylljen e tij

Plani per menaxhimin e tretesve organike:

Nje tretës është një substancë që shkrin nsubstancia te caktuara qwe mund te jete një lëng kimikisht i dallueshem, substance e ngurtë ose gaz, që rezulton në një solucion. Tretesi eshte zakonisht një likuid por mund të jetë gjithashtu një solid ose një gaz. Tretesi mund te ndryshoje me temperature, Përdorime të zakonshme për tretësve organik janë në pastrim kimik (p.sh., tetrachlorethylene), si hollues bojë (p.sh., toluen, terpentinë), si acetone dhe tretës adezivi (acetone, acetate metil, etil acetat), në tretes te castit (p.sh.hexane eter nafte), në detergjentë (terpenes agrume) dhe në parfume (etanol). Uji është një tretës për të gjitha molekulat polare dhe tretësi më i zakonshme i përdorura nga gjallesat; te gjitha jonet dhe proteinat në një qelizë jane tretur në ujë brenda një qelize.Tretësit kane gjetur aplikime të ndryshme në kimine farmaceutike, vajra, dhe industrinë e gazit, duke përfshirë edhe në sinteza kimike dhe proceset e pastrimit.

Shkarkime aksidentale në atmosferë i pluhurave apo i gazrave

Produkti i leshuar	Aktiviteti
Gaze dhe aroma	Shkarkime ne ajer nga solvente te ndryshem dhe VOC

Faza te administrimit te emergences:

<p>1. Vleresimi i rrezikut</p> <p>Personi qe e ka shkaktuar ose e ka identifikuar situaten duhet te vleresoje nese behet fjale per nje emergjence te perballueshme menjehere apo eshte e nevojshme nderhyrja e nje skuadre nga jashte.</p> <p>Ne rastin e pare, duhet te aktivizohen menjehere te gjitha masat lehtesuese te disponueshme ne vend. Ne rastin e dyte lajmerohen Zjarrfikesat dhe/ose Ndermarrja Shendetsore Lokale.</p>
<p>2. Lajmerimi i emergjences</p> <p>Ne çdo rast, duhet te lajmerohen per emergjencen drejtori dhe pergjegjesi teknik i impiantit , per te koordinuar nderhyrjet e mundshme dhe per te vleresuar pasojat e nderhyrjeve te ndermarrja.</p>
<p>3.Nderhyrje</p> <p>Te behen perpjekje per ndalimin ose kufizimin e daljeve duke pasur kujdes per sigurine e personelit, te bllokohet sistemi transportit dhe ushqimit te gazit natyror, te permbahet shperndarja e daljeve ose bashkedeperimi drejt rrjedhjeve te ujit; aspirim dhe /ose terheqje me materialet dhe mjetet e pershtatshme te materialit te shperndare te verifikohet bonifikimi i zones se prekur nga dalja.</p>
<p>4.Heqja e materialeve</p> <p>Personi qe ka bere nderhyrjen duhet te beje, aq sa eshte ne kompetencen e tij, edhe heqjen e largimin e pluhurave te thithur; keto duhet te depozitohen ne menyre te pershtatshme dhe te tjetersohen prane zones se depozitimit te mbeturinave.</p>
<p>5.komunikimi dhe regjistrimi i operacioneve</p> <p>Ne mbylljen e situates emergjente duhet te plotesohet raporti mbi incidentin.</p>

Keshilla per ruajtjen, perdorimin dhe me pas asgjesimin e mbetjeve te solventeve organike te qendrueshem

Përdorimi dhe ruajtja e kimikateve (Solventeve)

- Magazinoni kimikatet, si bojera, solventët dhe additivët ne nje zone te pershtatshme dhe te izoluar ne menyre qe nqs.ato aksidentalisht rrjedhin te mos perzihen me rrjedhen e ujerave te shiut dhe perfundojne ne ujerat siperfaqesore.
- Kontrolloni zonat e magazinimit rregullisht për shenja të rrjedhjeve ose dëmtim te kontejnerëve
- Sigurohuni që ju keni te dhena te perditshme për çdo kimikat të përdorur ose të ruajtur.

Mbetje të rrezikshme

- Mos përdorni avullimin si metodë deponimit të mbeturinave të paqëndrueshme kimike
- Nuk lejohet që kimikatet të groposen në tokë

- Magazinoni mbeturinat e rrezikshme të lëngshme në një zonë të mbuluar dhe të rrethuar kështu nuk do keni derdhje
- Mos i hidhni lëngjet e rrezikshme në koshin tuaj të mbeturinave të ngurta
- Sigurohuni që mbeturinat tuaja janë transportuar dhe asgjësuar në mënyrë të ligjshme

Kuadri i masave teknike dhe organizative

Cfare	Si
Parandalim	<ul style="list-style-type: none"> - Kontroll periodik i gjendjes teknike dhe mjeteve te transportit dhe pajisjeve te punes. -Perzgjedhja dhe trajnim i personelit per te garantuar nje produkt perfundimtare sipas kerkesave te klienteve dhe me kushte te larta higjieno-sanitare -Pajisja e punonjesve me mjetet e pershtatshme mbrojtese si doreza, maska etj. -Vendosja e tabelave sinjalizuese ne raste emergjente te zjarrit, pikat e grumbullimit etj.
Kontroll	<p>Sigurimi i te githa pajisjeve te nevojshme per riparim, pastrim dhe nderhyrje ne rast emergjencash.</p> <p>Lagje e sheshit te punes dhe rrugeve hyrese dhe dalese</p> <p>Testim periodik i teknologjise se perdorur</p> <p>Fikje e pajisjeve te punes pasi cdo proces te kete mbaruar.</p> <p>Levizje e ngadalte e automjeteve ne fabrike dhe jashte saj.</p> <p>Larje e shpeshte e makinerive.</p>
Nderhyrje	<ul style="list-style-type: none"> -Sigurimi i te gjitha pajisjeve te nevojshme per riparim, pastrim dhe nderhyrje ne rast emergjencash. - Aktivizim i menjehershem i stafit dhe mjeteve ne rast emetimesh dhe derdhjesh te pa parashikuara nga procesit teknologjik. - Njoftim i menjehershem i autoriteteve dhe njesive te specializuara ne rast emergjencash (zjarrfikes, autoambulanca) Monitorim i vazhdueshem i treguesve te mjedisit. <ul style="list-style-type: none"> - Dezinfektimi i ambjenteve te punes
Administrim	<ul style="list-style-type: none"> -Perdorimi dhe ruajtja me pergjegjesi i te gjithe infrastruktures dhe makinave sipas skemes dhe rregullave teknologjike. - Ndarje e pergjegjesise dhe adresim i sakte per ceshtje te sigurise Cdo punonjes te kete eksperience pune dhe te njohe mire rregullat e punes dhe mirembajtjes.

Masat zbutese per mbrojtjen e mjedisit

Nr.	Ndikimi	Masat zbutese
1	Clirimi i aromash dhe gazesh gjate kryerjes se proceseve te punes	Perdorimi i shtypshkronjes ne oret me energji elektrike nga rrjeti.
2	Ndotje te ujrave siperfaqesore si pasoje e derdhjes se ujrave qe gjenerohen nga aktiviteti	Subjekti ndodhet larg ujerave siperfaqesore por eshte njohes i mire i ligjit dhe ushtron aktivitetin e tij duke respektuar normat e percaktuara ne VKM 177date 31.03.2005Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjediseve ujore pritese.
4	Ndotja e tokes dhe ujrave nentokesore	Duhet realizuar betonimizimi i siperfaqeve te shtypshkronjes. .Ne raste aksidentesh te merren te gjitha masat per rikuperimin e ndotjes. mbjellje e bimesise ne zone
5	Manaxhimi i mbetjeve	Lidhja e kontratave me subjekte te licensuara me licensat e kategorise III.1.A/B dhe III.2.B nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, per grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve ose nga vete subjekti. Per mbetjet urbane do behet depozitim i tyre ne kosha te percaktuar nga Pushteti Vendor.
6	Siguria e punonjesve	Subjekti duhet te marre masa per te vendosur nje sistem kunder zjarri ose isktintore ne pika te ndryshme te shtypshkronjesh. Te vendosen sinjalistika e nevojshme dhe dyert e emergjences dhe te kryhet trajnimi perkates i punonjesve. Punonjesit te pajisen me uniforma pune dhe te gjitha mjetet mbrojtese si doreza dhe maska.
7	Rritja e trafikut te mjeteve te renda ne trafikun tokesor, por ne nivele te uleta	Shoqeria duhet te kete ne konsiderate: <ul style="list-style-type: none"> - te perdori infrastruktures ekzistuese, - perdorimi i mjeteve te kolauduara, - qarkullimi ne orare me trafik me pak te renduar, - reduktimi i renies se borieve ne zona te banuara, - organizimi i hyrjes dhe daljes se mjeteve te renda nga fabrika etj.
8	Zhurma nga veprimtaria	Procesi teknologjik nuk shoqerohet me nivele te larta te zhurmes. Ne pikat ku niveli i zhurmes eshte me i larte dhe koha e ekspozimit me e gjate te merren masa per punonjesit qe jane te ekspozuar duke perdorur mjete mbrojtese.

Masat per mbrojtjen e ajrit nga makinerite e transportit

Nr.	Ndikimi	Masat zbutese
1	Pluhura dhe gaze te shkarkuara gjate fazes se transportit dhe gjate procesit te prodhimit	Mjetet e transportit duhet te levizin me shpejtesi te ulet gjate transportit mjetet duhet te pastrohen vazhdimisht. Nevojitet te kontrollohet vazhdimisht gjendja e tyre teknike, dhe te kryen serviset periodike te nderrimit te filtrave. .
2	Emetim zhurmash, vibracioni dhe aromash	Duhet te kontrollohen vazhdimisht pajisjet dhe ambientet e punes per zhurmen e shkaktuar. Edhe per kete ndikim duhet te shkurtohet ne maksimum koha e mbajtjes ndezur te motorave te mjeteve;